

VENDIM
Nr. 94, datë 7.9.2016

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR TRANSFERIMIN E KONTROLLIT
(TË TËRTHORTË) NË MASËN 97.64 PËR QIND TË KAPITALIT TË VENETO
BANKËS SHA, TE *QUAESTIO CAPITAL MANAGEMENT SGR S.P.A.*, ITALI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 1, shkronjat “gj” dhe “h”, dhe të pikave 3 dhe 4 të nenit 24, si dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 17, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; të nenit 4, pika 2, si dhe të pikës 21 të shtojcës 1, të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin për transferimin e kontrollit (të tërthortë) në masën 97.64 (nëntëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e katër) për qind të kapitalit të Veneto Bankës sh.a., te shoqëria *Quaestio Capital Management SGR S.P.A.*, Itali.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko